



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačkog Borge
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

Datë: 10/04/2026

FTESË PËR APLIKIM

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR PROJEKTET E OJQ-VE NGA
FUSHA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës 10.04.2026 të publikuar nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të;
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në vlerësim të projekteve të OJQ-ve;
- Të mos kenë dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente

- Një CV të përditësuar;
- Një letër motivimi;
- Kopjen e Diplomës (kopje e noterizuar);
- Dëshmitë e përvojës së punës;
- Dëshmitë e përvojës në vlerësimin e projektet të OJQ-ve;
- Certifikatën mbi dënimet penale;
- Deklaratën nën betim nga aplikuesi se nuk është i emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar apo angazhuar.

Ekspertët e angazhuar nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, do të kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

Aplikimi mund të bëhet duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, ***Rruga/Street "Edit Durham", nr.46, 10000 Prishtinë Zyra e Arkivit në MPFVLÇ/ Sheshi Zahir Pajaziti.***, apo përmes postës deri me datën **22 Prill 2026 në ora 16:00.**

Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar me kohë dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës **10.04.2026** të publikuar nga Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare.